



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Për:	Zenun Elezaj, Kryetar i Komunës së Klinës Fadil Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Klinës
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL Jeton Qela Sekretar i Përgjithshëm në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Liburn Aliu, Ministër i MMPHI Izedin Bytyqi, U.D Sekretar i Përgjithshëm në MMPHI
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor
Zyrtarët përgjegjës:	Nr. VL 27/25 Datë: 07.03.2025
1.Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Shendrita Latifi – Zyrtare Ligjore në Divizionin për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit të
2.Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit komunal
Lloji i aktit:	Vendimi 01 Nr. 6125/25 për Vënien në Diskutim Publik Draft Planin Zhvillimor Komunal të Klinës 2025-2033, miratuar nga Kuvendi Komunal i Klinës, datë 28.02.2025

I nderuar kryetar Elezaj,
I nderuar kryesues Gashi

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, (MMPHI) në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, me datë 04.03.2025 ka pranuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Vendimin 01 Nr. 6125/25 për Vënien në Diskutim Publik Draft Planin Zhvillimor Komunal të Klinës 2025-2033, miratuar nga Kuvendi Komunal i Klinës, datë 28.02.2025.

MMPHI pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave kërkon nga Kuvendi Komunal i Klinës:

RISHQYRTIMIN E LIGJSHMËRISË SË AKTIT

Vendimi 01 Nr. 6125/25 për Vënien në Diskutim Publik Draft Planin Zhvillimor Komunal të Klinës 2025-2033, miratuar nga Kuvendi Komunal i Klinës, datë 28.02.2025.

ARSYETIMI

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës pas shqyrtimit të Vendimit të shënuar më lartë, konstatoi se:

Preambula dhe përmbajtja e vendimit duhet të korrigjohet dhe plotësohet në përputhje me nenet përkatëse (neni 5, 15 dhe 20) të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, si dhe me Udhëzimin Administrativ MMPHI-NR.05/2014 për Procedurat e Pjesëmarrjes së Publikut në Planifikimin Hapësinor.

Të bashkëngjitur gjeni shembullin nga Komuna e Deçanit, e cila së fundmi ka marrë vendimin për vendosjen në diskutim publik.

Nga ajo që u tha më lartë, të veprohet sipas vlerësimit të ligjshmërisë së aktit komunal nga MMPHI, të merret vendim i drejtë dhe i ligjshëm në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, jo më vonë se afati i paraparë në dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave.





REPUBIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

**Komuna e Klinës
Kuvendi i Komunës**

**01Nr. _____ 2025
Klinë**

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Kuvendit të Komunës së Klinës, mbajtur me datë 28. 02. 2025, në sallën e Kuvendit, nisur nga ora 10:00.

Pjesëmarrës në mbledhje, kryetari i komunës së Klinës, z. Zenun Elezaj, nënkryetarja e komunës, znj. Marqe Selmanaj, përfaqësues të OSBE, anëtarë të kuvendit, media dhe qytetarë.

Mbledhjen e hapi kryesuesi i kuvendit, z. Fadil Gashi I cili përshëndeti gjithë të pranishmit. Konfirmoj se prezent janë 24 anëtarë të kuvendit. Asdren Ramadani dhe Armend Beqiri nuk do të marrin pjesë , ndërsa Ilir Hoti është në ardhje. Kryesuesi hapi debat rreth rendit të ditës. Për Rendin e Ditës fjalën e morri z. Kushtrim Haliti I cili tha se nuk e ka marr materialin e mbledhjes. Për këtë morri sqarimin nga zyrtari përgjegjës I cili sqaroi se problem është tek kapaciteti I mbushur I inbox në emalin e z. Haliti. Për zgjidhjen e këtij problem është pak problem sipas kryesuesit sepse zyrtari I IT e ka lënë punën. Në këtë çështje u kyç edhe drejtori I administratës z. Binak Sylaj I cili tha se deri në momentin e rekrutimit të zyrtarit të ri në IT mund të I drejtohet , z. Arian Rexhepi, zyrtar I cili ka autorizimin.

Për rendin e ditës kryesuesi tha se ka pranuar një rekomandim për shqyrtim dy vendime të marruara në seancën e kaluar. Një për bartjen e mjeteve dhe tjetri për ndryshimin e vendimit për shujtat e punëtorëve të administratës. Sipas kryesuesit kjo është mos përgjegjësi e zyrtarëve në ministri të cilët nuk e shohim fare materien por thjesht na e kthejnë për rishqyrtim. Me hapat që do të merren për këtë çështje do të njoftoheni në vazhdimësi tha kryesuesi duke mos e përjashtuar edhe padinë nga ana e komunës ndaj ministrisë.

z. Esat Raci: Përshëndetje të gjithëve. Në lidhje me diskutimin e fundit për shujtat, shqetësimi I shërbyesve civil është se përse komuna ka bërë ankesë në gjykatën e apelit. Kjo ankesë e komunë po ka pastaj kosto të lartë.

z. Fadil Gashi, kryesues: Për të njëjtën çështje, materie të njëjtë, kategori të njëjtë, gjykatat kanë marrë tre vendime të ndryshme nga njëra tjetra. Një e ka aprovuar, një tjetër e ka refuzuar dhe një tjetër e ka kthyer në rishqyrtim.

z. Zenun Elezaj, kryetar I komunës: Pikërisht për këtë problematikë ne jemi duke u munduar që të kursejmë edhe mjetet edhe kohën prandaj kemi marrë vendimin në seancën e kaluar. Në seancën e ardhshme do të përgatitemi edhe me zyrën ligjore që ta trajtojmë këtë çështje.

z. Arben Limanaj: Përsëritet. Unë kam pak paqartësi tek pika 5 e rendit të ditës. Vitin e kaluar nuk ka ardhur për miratim por vetëm për shqyrtim raporti I punës së ekzekutivit. Pse kësaj radhe ka ardhur edhe të miratohet?

z. Fadil Gashi, kryesues: Shqyrtimi është I rëndësishëm , miratimin edhe mund të jetë edhe mos të jetë. E kemi diskutuar me zyrën për punë të kuvendit këtë çështje.

z. Valmir Bacaj: Përsëritet. Për këtë çështje dhe vitin e kaluar kemi diskutuar dhe miratimi do të duhej të hiqet.

z. Zafer Gashi: Përsëritet. Mendoj që edhe shqyrtimi por edhe miratimi është I vendosur me vend dhe duhet të qëndroj.

z. Fadil Gashi, kryesues: Për mua Miratimi nuk qëndron dhe nuk do të duhej të ishte. Të moshuarit e mbajnë mend se para lufte nëse nuk ju ka miratuar raporti I punës, administrator ish dashtë me shkua në shpi. Tani miratimi s` ka shumë rëndësi, shqyrtimi po.

z. Esat Raci: Ne si grup kemi marrë vendimin dhe nuk do ta votojmë raportin e punës për mos punën e duhur të ekzekutivit. Ju si të doni vendosni.

Që të hiqet “ Miratimi” nga raporti I punës u votua dhe me 13 vota për U MIRATUA.

Rendi I Ditës me 22 vota për, një kundër dhe një abstenim U MIRATUA

Pika 1e Rendit të Ditës: Arsytimi I mungesave

- Mungon Asdren Ramadani, Armend Beqiri

Pika 2 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi I procesverbalit nga mbledhja e kaluar

- Me 24 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA

Pika 3 e Rendit të Ditës: Pyetje dhe përgjigje

z. Kushtrim Haliti: Kam pyetje për drejtorin e urbanizimit: Gropat që janë bërë tek sheshi “Faruk Elezi” dhe tek hekurudha në rrugën për në Skenderaj, qytetarët po I mbushin me zhavorr, a mendoni që të I mbyllni pasi që është obligim I komunës? Renovimi I sheshit kryesor, ku keni intervenuar dëmi është bërë më I madh. Kubëzat janë ngritur aty ku janë vendosur.

z. Enver Berisha, drejtor I urbanizmit: Përsëritet. I kemi verifikuar ato gropa dhe ne jemi në procedura të një projekti të quajtur “Sheshi I unazës” të gjitha ato gropa do të mbulohen me asfalt. Në rrugën për Skenderaj ajo rrugë është në përgjegjësi të ministrisë por do të shohim dhe ta riparojmë.

z. Qendrim Millaku, drejtor I SHPE: Përshëndetje. Kompania ka intervenuar tek sheshi. Tek hekurudha, kompania I ka mbushur gropat me zhavorr. Posa të fillon rregullimi I kohës dhe të nis kompania me punë, ajo do të I mbuloj me asfalt.

z. Esat Raci: Prap prindërit e nxënësve të shkollës fillore “Ali Krasniqi” në Ujmir kanë shqetësim me gjendjen e shkollës, sidomos për nyjat sanitare.

z. Qemajl Sejdiu, drejtor I DKA: Përshëndetje. E vërtetë, edhe pse kemi intervenuar në atë shkollë duke I ndërruar të gjitha dyert dhe dritaret aty ka nevojë që të investohet dhe të rinovohet. Në momentin që kryhet procesi mësimor do të intervenohet në atë shkollë.

Znj. Besiana Gashi: Përshëndetje. Kam një shqetësim nga anëtarët e komitetit për komitete për pagesat e atyre që nuk I kanë marrë.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Unë e kam dhënë një autorizim dhe mendoj që shumë shpejt do të nisin pagesat.

z. Tunë Dedaj: Përshëndetje të gjithëve. Kam një pyetje për drejtorin e urbanizimit: Pse nuk ju ka dhënë toka Gjon Berishës pasi që ju ka marrë toka për rrugë.

z. Enver Berisha, drejtor I urbanizimit: Mendoj që duhet të shihen të gjitha mundësitë ligjore dhe të vepohet.

Znj. Lirie Gashi: përshëndetje të gjithëve. Kam një kërkesë nga qytetarët për drejtorin e shëndetësisë që dhomat e infuzioneve të jenë më të pastërta.

z. Agron Bacaj, drejtor I shëndetësisë: Besoj që ajo vjen nga fluksi I madh I pacientëve. Ato dhoma pastrohen dy deri në tre herë në ditë por gjithsesi që pastërtia duhet të jetë e duhura.

z. Zafer Gashi: Përshëndetje. Muajin e kaluar ju kam pyet për fabrikën e ujit. Keni thënë që janë në pyetje disa valvule. Tani është muaji I tretë dhe s` ka ujë, a është në funksion fabrika e ujit. Pyetja e dytë: Pse nuk e tërhiqni lejen për fabrikën e çimentos? Pyetja e fundit: Në shumë seanca kanë qenë kërkesat e njerëzve për këmbimin e disa pronave. A keni vullnet që të na sjellin një listë për vitin 2024 se kujt I keni dhënë përgjigje pozitive dhe kush ka mbet në shqyrtim.

z. Zenun Elezaj, kryetar: Në fund të çdo viti ne si kuvend miratojmë listën e pronave që do të epen në shfrytëzim. Në seancën e kaluar ne kemi miratuar rregulloren për tarifa që ka qenë pengesë për iniciimin për dhënien në shfrytëzim për mes ankandit publik të këtyre pronave. Mbledhjen e kaluar e kemi aprovuar por ka ardhur antiligjore, është udhëzuar që të [plotësohet rregullorja në fjalë. Për fabrikën e ujit dhe atë të çimentos besoj që përgjigje ka drejtori I urbanizimit.

z. Enver Berisha, drejtor I urbanizimit: Fundërruesi është në fazën finale, ju kemi dhënë një afat shtesë sipas teknologut. Ai ka kërkuar që të furnizohet me kimikate dhe ne mendojmë që së shpejti do të finalizohet. Tani është duke u bërë lidhja elektrike dhe sipas afatit që I kemi dhënë deri në fund të marsit do të përfundohet. Sa I përket fabrikës së çimentos ne nuk kemi ndo një vendim të prerë që të na këtë ardhur. Në momentin që do të vije ai vendim ne do të veprojmë,

deri atëherë nuk mund të marrim veprime sepse mund të bëhemi pjesë e ndonjë padie që mund të na bëjë dëm të madh.

z. Arben Limanaj: Kam një pyetje për drejtorinë e urbanizimit. Është diskutuar edhe më herët çështja e rrugës nga ura deri në qytet dhe shtyllat e ndriçimit që janë pengesa të mëdha për automjetet e madhja si dhe qasja e hyrjeve të bizneseve. A mund të shikohet ndonjë përmirësim pasi që edhe është biseduar më herët për këtë mundësi.

z. Enver Berisha, drejtor i urbanizimit: Njëra pjesë veç se ka përfunduar. Ne jua kemi krijuar qytetarëve qasje më të lehtë duke e ulur anësoren. Ndërsa sa i përket ndriçimit, ne mendojmë që me projektin e tanishëm që jemi duke e ekzekutuar, të krijojmë një vijë e cila e largon 50 cm nga trotuari e nga ndriçimi. Në përfundim do të ketë funksionalitet të plotë i tërë projekti. Jemi përpjekur që të mbrohet qytetari pasi që qytetari ka vlerë më të madhe se sa një dëm material. Jemi në gjysmë të punimeve, mendoj që kur të përfundoj projekti do të ketë funksion të plotë.

Znj. Mendehe Duraku: Përsëritet që gjithëve. Kam një pyetje për drejtorin e arsimit: a lejohet që në çerdhen e qytetit të ndryshohet orari i punës së edukatorëve. A ka mundësi që këto edukatore ta mbajnë orarin e punës deri në orën 16 e 30 pasi që shumë nëna detyrohet ta lëshojnë orarin e punës para kohe që të marrin fëmijën nga çerdhja.

z. Qemajl Sejdiu, drejtor i DKA: derisa kemi pasur mundësinë që të i paguajmë për punë shtesë ne i kemi paguar edukatorët deri në orën 16 e 30. Tani më na është hequr kjo mundësi. Është rregullorja që i përcakton mjaft mirë punën e edukatoreve dhe ne nuk mund të bëjmë asgjë jashtë udhëzimeve dhe rregulloreve. Ndalesa që është bërë për shtesa na ka krijuar këtë pamundësi.

z. Esat Raci: Dëshiroi të lidhem me projektin që e përmendi drejtori i urbanizimit: Sa është plani dinamik i realizimit të projektit të rrugës nga ura deri në qytet. Ka reagime të mëdha nga qytetarët për atë Projekt.

z. Enver Berisha, drejtor i urbanizimit: Unë mendoj që projekti është i qëlluar. E kemi transitin që është me korse të shpejt ndërsa rruga në fjalë është vend urban dhe duhet të ketë shpejtësinë e kufizuar. Ky projekt është tre vjeçar dhe shumë shpejt do të përfundojnë punimet. Për riasfaltim kemi biseduar me ministrinë dhe shumë shpejt do të jetë edhe kjo e realizuar.

z. Kushtrim Haliti: Kam një pyetje për drejtorin e inspektorëve: Që tre vjet që je drejtor a ke dalë ndonjëherë në lokale të shikosh se si nxënësit nga ora 11 deri në orën 13 se si pijnë alkool.

z. Faruk Smajli, drejtor i inspektoratit: Përsëritet. Nuk e di sa kemi kompetencë që të kontrollojmë nëpër lokale se çka pijnë nxënësit aty. Nuk kemi pasur ankesa por do ta shohim në të ardhmen.

Pika 4 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve të KPF-së.

Kryesuesi tha se të gjitha rekomandimet janë në rend të ditës përveç një kërkesë që është rekomanduar në zyrën e kryetarit e që ka të bëjë me shkëmbim të pronës.

Me 25 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUAN

Pika 5 e Rendit të Ditës: shqyrtimi I raportit të punës së ekzekutivit për vitin 2025.

z. Zenun Elezaj, kryetar I Komunës: Raporti I punës është një raport që përfshin në vete të gjitha të arriturat, projekte që janë realizuar gjatë vitit 2024. Viti 2024 ka qenë vit I realizimit të projekteve dhe planifikimet e punës. Ka qenë një vit ku kemi realizuar debate të nevojshme nëpër fshatra për hartimin e buxhetit, debate me qytetarë. Klina ka qenë një nga komunat më transparente në nivel vendi dhe një çështje shumë më rëndësi është raporti I auditorit të përgjithshëm që ka nxjerr 8 rekomandime nga të cilat dy janë realizuar menjëherë ndërsa 6 të tjera janë në realizim e sipër. Jemi këtu që ta diskutojmë këtë raport e ti japim përgjigje dhe të përmirësohemi sa më shumë që të jetë e mundur. Ju faleminderit.

z. Enver Berisha, drejtor I FEZH: Përsëritet të gjithëve. Kam një informatë shtesë për këtë raport . Për shkak të performancës dhe transparencës kemi vendosur që të ja bashkëngjitem edhe rekomandimet e auditorit të përgjithshëm këtij raporti të punës. Shefat e grupeve parlamentare e kanë marrë këtë raport shtesë.

z. Esat Raci: Ne jemi përgatitë për mos votim të këtij raporti të punës. I përgëzoj të gjithë ata shërbyes civil që kanë bërë punë të mira. Ne si grup kuvendar kemi shumë pakënaqësi rreth punës që është bërë në vitin 2024. E lexova dhe e rilexova raportin e punës së ekzekutivit dhe pasi që është vetëm shqyrtim do të ndalem tek shqyrtimi. Nëse do të ishte Shqyrtim I punës së ekzekutivit do të kisha shumë për me folë, me shprehë shumë pakënaqësi, me tregu shumë parregullsi dhe diskriminime politike që ky ekzekutiv I ka bërë prej trajtimit të shërbyesve civil, tek punësimet e kamufluara politike, tek ndarjet e subvencioneve nga zyra e kryetarit , tek ndarjet e makinerive bujqësore për fermerët dhe listat e përzgjedhura që I shkojnë të gatshme komisionit për vlerësim e deri tek projektet kapitale të shtrira nëpër zonat që ekzekutivi mendon se I ka votues të tyre. Kjo e fundit ka treguar me 9 shkurt që qytetari pavarësisht nevojave të mëdha që I ka nuk blihet as me punësim as me multikultivator. Gjatë leximit të këtij raporti të punës kam hasur në shumë mospajtime, pa përputhshmëri në mes vetë sektorëve kur është fjala te matematika si shkencë ekzakte e deri tek raportimi për punë që fare nuk janë kryer. Drejtorja e administratës thotë në këtë raport se ka arritur objektivat e planifikuara si: Qytetarët të bëhen pjesë aktive e vendimeve në komunë. Pyetja: Në cilin rast qytetarët janë bërë pjesë e vendimeve të ekzekutivit? Nëse aludohet në dëgjimet buxhetore, ato dëgjime nuk I ka organizuar ekzekutivi por kuvendi I komunës dhe po ashtu vendimi për buxhetin është I legjislativit e jo I ekzekutivit. Nëse aludohet në zgjedhjen e këshillave të fshatrave, ato janë vendime direkt të qytetarëve e jo të ekzekutivit. Tutje shkruan në raport: Klina me platformë digjitale për pjesëmarrje me publikun. Nuk e kuptoj për çfarë platforme digjitale e keni fjalën në të cilën merr pjesë edhe publiku bashkë me ju? Lajmërimi nga qytetarët për parregullsi në çdo kohë dhe në çdo vend. Si e keni realizuar dhe mundësuar këtë gjë? Në çfarë forme po ju lajmërojnë qytetarët? Sa raste ka që ju kanë lajmëruar qytetarët për parregullsi, Çfarë keni bërë për të përmirësuar parregullsitë dhe çfarë masash keni marrë ndaj atyre që kanë krijuar parregullsi? Sipas këtij raporti në këtë drejtori paska pasur edhe projekte kapitale të realizuara si ajo e Ndërtimi dhe rinovimi i objektit të Komunës. Të nderuar, ndërtimi I objektit të komunës është bërë në vitin 2011 e jo në 2024. Nëse mendoni që një lyerje amatore më poli kolor e zyrave brenda objektit është ndërtim dhe rinovim atëherë po jua bëjë me dije se as ne as qytetarëve nuk mund të jua nënçmohim inteligjencën e me

ju shpall këtë tog fjalësh kaq madhështor. Në raport tek sektori I zyrës për informim. Aty thuhet se janë bërë publike 116 kontrata publike, ndërsa në raportin e punës së zyrës së prokurimit shkruan se gjatë vitit 2024 janë zhvilluar 117 kontrata. Pse një kontratë nuk është bërë publike? Cila është ajo kontratë? Çfarë vlere ka pasur dhe kush është OE që ka realizuar atë kontratë. Zyra e personelit. Kjo zyre e nis raportin e punës me një lapsus duke thënë: Gjatë vitit 2023 kjo zyre ka zhvilluar për administratë gjithsejtë 10 konkurse dhe procedura... A e din zyra e personelit që është kërkuar raport për vitin 2024 e jo 2023? Nëse e quani gabim teknik- a e ka rilexuar zyrtari që e ka punuar , a e ka lekturuar dikush? Apo është thjesht pakujdesi siç janë shumë pakujdesi të tjera nga kjo zyre ku më pastaj anulohen konkurse, hetohen konkurse nga organet e hetuesisë. Ju informoj se një material voluminoz për të gjitha punësimet në komunë është dërguar në organet përgjegjëse. Në këtë material përveç fakteve që e pasqyrojnë ndikimin politik në punësime ka edhe fakte për mënyrën e parregullt të ngritjes së koeficienteve nga 3 në 1 për disa zyrtarë që janë aktivistë të partisë në pushtet. Zyra për komunitete dhe kthim Sipas raportit del që kjo zyre është përgjegjëse për sigurinë dhe lëvizjen e lirë të qytetarëve. Siguria dhe lëvizja e lirë e qytetarëve sipas kësaj zyre është e mirë. Gëzohem shumë që është e tillë por nuk është përgjegjësi e kësaj zyre të raportoj për situatën e sigurisë por për punën që kjo zyre e ka kryer. E për punën e kryer kjo zyre mjaftohet vetëm me dy rreshta: Zyra ka kryer punën e saj të përditshme në teren. E fundit që dua ta theksoj është drejtoria e Kulturës e cila e fillon raportin me fjalët: Sektori I kulturës gjatë tërë vitit ka realizuar punët në bazë të raportit të punës dhe disa që nuk ishin të planifikuara...Nuk e kuptoj qysh po u realizuakan punët bazuar në raportin e punës? Punët gjatë vitit realizohen duke u bazuar në planifikimin e punës. Në fund për projektet kapitale. E kemi ngrit si shqetësim vazhdimisht. Premtim I kryetarit të komunës ka qenë se në nëntor do të kemi ujë të pijshëm, tani jemi në mars. Edhe pse tha drejtori se jemi në fazën finale, për mua është e pa besuar.

z. Valmir Bacaj: Ne e kemi pranuar planin e punës së ekzekutivit. Nëse e shohim këtë raport shihet se puna është bazuar në planin e punës. Përkundër sfidave kryetari Elezaj ka arritë që të përmbush nevojat e qytetarëve. Sa i përket asaj që tha Esati, e kuptojmë që zgjedhjet lokale janë afër prandaj edhe ka akuza të pa baza. Ja kujtoj Esatit se Aleanca ka rritje të votave nga viti 2021. Ju e keni fituar atë natë [por kish qenë më mirë me I prit rezultatet, LVV ka dalë e para dhe ju e dini se çka I pret ata që në zgjedhjet qendrore dalin të parat, në zgjedhje lokale del e fundit. Nuk do të ja dëshiroja atë fat PDK-së. Sa i përket akuzave për punësimet, kampion I parregullsive dihet se ka qenë pushteti që përfaqësoni ju. Qytetarët I dinë të gjitha këto dhe me të drejtë e vlerësojnë punën e ekzekutivit dhe të Zenun Elezajt.

z. Esat Raci: Jemi duke folur për raport të punës dhe jo për zgjedhjet lokale.

Në vazhdim ka një dialog me mikrofon të mbyllur.

z. Zafer Gashi: Jashtë rendit të ditës u fol këtu për zgjedhjet. Është bërë si trend ajo thënia “New Sheriff in the town”, pra kemi një sherif të ri, keni pak respekt, dihet kush është e para. Është e vërtetë, u tha edhe nga Esati që ka mjaft për të dëshiruar dhe për përmirësim. Thuhet në popull “Kur u prish , kur u nis”, u prish në votimin e buxhetit që LVV nuk e ka votuar sepse e ka dijt që s` ka me u realizuar ashtu siç është planifikuar. Në përgjithësi ka dalë që s` ka pasur profesionalizëm, tenderomania ka bërë që shumë projekte të dështojnë, të prishen rrugët

menjëherë pasi janë shtruar, Kanale të ujitjes të ndërtuara keq, shtrimi I rrugëve nëpër oborre të militantëve për mbledhje të votave etj. Drejtoria e arsimit në këto tre vite ka qenë si është me keq kur është fjala për zgjedhjen e drejtorëve të shkollave. Kandidatët jua kanë bërë argatin njeri tjetrit. E tha Esati për drejtorinë e bujqësisë. Falë zotit që aty janë disa shërbyes civil shumë profesionist sepse ka pasur gjithçka. Së pari drejtori është në një kontest gjyqësor dhe I dënuar dhe kryetari e lejon të punoj akoma. Është shqetësim I qytetarëve. Drejtoria e urbanizimit si një nga drejtoritë më të rëndësishme të komunës ka shumë vërejtje. Polemika të panevojshme- fyerje lidhur me ambientin që nuk është mbrojtur. Kam kërkuar vazhdimisht për gurthyeset që nuk dihet a janë kontrolluar. Tek inspektorati e pashë që nuk janë dënuar këta gurthyes as kontrolluar. Tek urbanizmi secilin projekt që ta marrim shohim që nuk është kryer komplet. Qytetarëve duhet të ju tregohet e vërteta.

z. Gashi foli edhe për rrugën prej urës e në qytet. “Shumë prej pengesave janë hekur e prishur, pa u përfundua rruga janë prishur. Pastaj fundërruesi, po thoni që është në rregull por ujë nuk ka. Trotuari në Sferkë e ka pranuar vet kryetari që është dështim. Mendoj dhe besoj që do të jetë viti I fundit I qeverisjes suaj”, tha në fund z. Zafer Gashi.

z. Arben Limanaj: të nderuar të pranishëm, roli I grupit tonë kuvendar ka qenë shumë konstruktiv vazhdimisht. Unë dëshiroi të I përmend disa nga propozimet tona që I kemi thënë këtu por që ekzekutivi nuk është marrë fare me to. Shembull, sheshi “Ibrahim Rugova”, tjetër kam propozuar më shumë se një vit- rregullimin e statusit të shtëpisë së kuvendeve në Bokshiq, ekzekutivi nuk është marrë fare me të. Po ashtu shqetësim të paraqitur më herët , një trotuar në Caravik që kemi propozuar shkaku I aksidenteve të shumta, asnjëherë nuk është marrë askush me këtë propozim. Një shqetësim tjetër nga një qytetar për një kanalizim që ju është lënë njerëzve para dyerve të shtëpisë, për këtë e kam biseduar dhe kërkuar që të realizohet ky projekt por ashtu është lënë pa lëvizur. Ankesat dhe shqetësimet e qytetarëve deri në formën e diskriminimit partiak, para dy ditëve morra shqetësimin e një qytetari që nuk ju ka shtruar rruga shkaku I përkatësisë së tij partiake. Lagja e “Zeqajve” në Bokshiq janë detyruar që ta paguajnë kompaninë nga parat e tyre që të jua shtroj rrugën në lagje ndërkohë që në lagjet e tjera ju shtrohet nga komuna. Për krejt këto shqetësime që I kemi paraqitur vazhdimisht asnjëherë nuk I kem I marrë përgjigjet.

z. Tunë Dedaj: Unë e kuptoj që këta si opozitë mundohen të gjejnë ndonjë vërejtje por ekzekutivi ka kryer punë në mënyrë të shkëlqyer. Këtë do ta shohim se si do ta vlerësojnë qytetarët pas 8 muajve. Ngadalë dalë dhe do të dalim faqebardhë, kryetar vazhdo me këtë ritëm të punëve dhe jam I sigurt që qytetarët kanë me të përkrahë.

z. Kolë Prenaj: Përshëndetje. Jemi në një pozitë që jemi duke I përzier zgjedhjet qendrore me rezultatet dhe sukseset e ekzekutivit. Nuk mund të them se çdo gjë është e përkryer, çdo njeri mban përgjegjësi për mos punë , ka ankesa por ka edhe më shumë lëvdata. A ka përgjegjësi a merr dikush përgjegjësi për dështimin tek uji I pijshëm përpara. Çështje tjetër është sheshi. Para disa seancave kemi biseduar se si me I hekë këto kubëza sepse janë kancer për qytetarët. Çka mundemi edhe për këta muajt që kanë mbetur dhe të jemi të kënaqur të gjithë e nuk është korrekte që të akuzojmë njeri tjetrin.

z. Binak Sylaj, drejtor I administratës: Më vëmendje I kam shkruar të gjitha ato që I potencuat ju Esat. E shoh që është një fushatë që ka nisur pak më herët por është demokratike dhe e kuptoj. Ju vet keni qenë drejtor I administratës dhe e dini që asnjë administratë nuk punon pa I përcaktuar objektivat. Drejtoria e administratës e them me përgjegjësi të plotë që të gjitha objektivat I ka arritur. Kur pyesni se në cilën situatë qytetarët janë pjesë aktive e vendim marrjes, më mirë është të pyesni se në cilat raste qytetarët nuk ka qenë pjesë. Të gjitha dëgjimet publike hartohen dhe realizohen këtu dhe aprovohen nga ky kuvend dhe implementohen nga ekzekutivi. Nuk do koment më të madh se sa një komunë kur e zënë vendin e parë për transparencë, prandaj digjitalizimi dhe informimi I qytetarëve ka qenë dhe është në nivelin e duhur. Për parregullsi është mirë që të ceken ato parregullsi që ju I mendoni, unë nuk e kam një vërejtje nga ndonjë zyrtar. Ndërtimi dhe renovimi I komunës, e thatë me të drejt që është ndërtuar në vitin 2011 por ne jemi obliguar që të merremi me rregullimin e çatisë dhe ky është kod , kështu quhet kodi ne nuk mund ta ndryshojmë. Sigurisht e dini që zyra e burimeve njerëzore ka funksionuar me një zyrtar , neve na është dashur që ta rinovojmë atë hapësirë dhe tani ajo është e mbyllur dhe dokumentet ruhen sigurt. Sa I përket sektorit të informimit, zyrtarja është këtu dhe mund të jua sqaroj, Unë kam komplimente dhe vlerësim për këtë zyre sepse falë punës së kësaj zyre , informimit dhe transparencës ne kemi dalur në vendi e parë për transparencë. Sa I përket kontratave të potencuar , zyra e informimit dhe ajo e prokurimit janë këtu dhe mund të ju japin informata shtesë pasi që ata I kanë punuar raportet e veta të punës.

z. Sylaj, foli edhe për mënyrën e rekrutimit të zyrtarëve publik, mënyrën se si poentohen dhe tha se zyra e burimeve njerëzore nuk mund të këtë asnjë ndikim në marrjen në punë të një zyrtari. Po ashtu z. Sylaj foli dhe ju kundërpërgjigj z. Raci edhe për zyrën për komunitete dhe kthim etj. duke shtuar se “Është mirë që qytetarëve të jua thoni të vërtetën qytetarëve, e ata informator që ju japin informata në këtë mënyrë të mos ju qesin në lajthitje”.

Znj. Vlera Tafilaj: Dua ta demantoj Esat Racin për punët e mija. Nuk kam qare pa e lavdëruar zyrën e prokurimit dhe atë të kuvendit për përkushtimin që kanë pasur për zyrën e informimit. Unë dua ta shpreh shqetësimin tim, para 19 orëve AKK ka dalë me një reagim. Shteti I Kosovës ka dështuar që të I organizoj web faqet e komunave. Dokumenti publikohet por fshihet prandaj ka reaguar asociacioni. Unë I kam ruajtur kopje dokumentet dhe kam kënaqësi të ja jepi Esatit.

z. Qendrim Millaku, drejtor I SHPE: Dëshiroj që të flas pak në lidhje me atë që e tha Esati për impiantin e ujërave të zeza në qytet. Dihet që impianti në qytet ka kosto të madhe milionëshe por ne kemi përfunduar impiantin e tretë në Gllarevë dhe kjo e dëshmon punën dhe përkushtimin e kryetarit të Komunës. Një gjë tjetër që dua të theksoi është se kur kemi ardhur ne në pushtet grandit I përformancës ka qenë 0 ose 45 mijë euro ndërsa tani është afër 1 milion euro, edhe kjo tregon shumë punën e ekzekutivit në krye me Zenun Elezaj.

z. Millaku tregoj edhe për përfitimin e grandit të qeverisë për renovimin e ndërtesave.

z. Enver Berisha, drejtor I urbanizmit: Ne e dimë që drejtoria e urbanizimit e menaxhon gati 75% të buxhetit dhe dua ta informoi edhe Esatin edhe Zaferin se kemi arritur që ta shfrytëzojmë 95.95 % të realizimit në të tri kodet. Në disa fshatra që ju I dini se militant të kujt jeni. I nderuar Esat shkoni dhe shikoni shtrimin e rrugëve në të gjitha lagjet e Gllareves pa pyet fare. Edhe në

lagjen e Zafer Gashit nuk kemi bërë asnjë dallim. Pushtet që nuk bënë dallime është ky, pushtet që bënë dallime e dimë kush ka qenë sepse kam qenë pjesë e juaja. Problemi tjetër është se Esati po thotë që nuk janë bërë punë të mira por shumicën e rasteve janë bërë jashtëzakonisht të mira dhe janë institucionet që e verifikojnë, bëjnë A testet. Kështu mendoj që do të vazhdojmë tutje. Ne nuk bëjmë dallime, dhe ne bëjmë fushatë gjatë fushatës dhe jo pas fushatës.

z. Esat Raci: Realisht unë në fillim e thash që I përgëzoj të gjithë shërbyesit civil gjithë drejtorët për punën e mirë që e aknë bërë dhe nuk ja heq asnjë presje asaj që e kam thënë. Ne kemi qenë parti e hapur për të gjithë kemi marrë nga Aleanca dhe I kemi bërë drejtor.

Debati në vazhdim u koncentrua më shumë në aspekte e të qenurit partiak I njëjës apo tjetrës parti.

z. Kushtrim Haliti: Dëshiroj që të I them drejtorit të Urbanizimit se nëse keni investuar në Gllarevë keni investuar sepse edhe ata janë qytetarë të Klinës dhe edhe ata janë taksa pages e sidomos njëri prej atyre që paguan më së shumti është kompania e Bujar Morinës. Po ashtu dua të pyes për një gyp të ujit tek Dushi që është shtrirë pse nuk është lëshuar uji akoma në atë pjesë.

z. Enver Berisha, drejtor I urbanizimit: Sa I përket gypit të ujit do të doja që të përgjigjet drejtori Qendrim Millaku ose kompania “Hidrodrini”

z. Zenun Elezaj, kryetar I komunës: Për atë që pyeti Kushtrimi, projekti ka qenë një investim I nxjerrë nga ministria me iniciativë të banorëve të Gllarevës dhe ai projekt ndërlihet me rrjetin e CDI, ne si komunë nuk e kemi asnjë kompetencë.

z. Lorenc Marleku, drejtor I Bujqësisë: Përshëndetje të gjithëve. Mendoj që Udhëheqja e drejtorisë nuk merret vetëm me subvencione por edhe me udhëheqje të punëve të tjera. Punëtorët në këtë drejtori pavarësisht se janë të partive të tjera janë shumë korrekt dhe profesionist. Sa I përket ndarjes së subvencioneve gjithmonë ato I kanë nda komisionet. Ne e bëjmë punën me 4 zyrtar ndërkohë që komuna e Skenderajt që është përafërsisht sa Klina, I kanë 7 zyrtar. Ne kur kemi ardhur në pushtet për drejtorinë e bujqësisë I kemi pasur vetëm 20 mijë euro për subvencione ndërsa tani I kemi 400 mijë euro.

z. Esat Raci: Drejtor, e keni sektorin edhe të ndjeshëm edhe pajtohem që punëtorët në këtë drejtori janë shumë profesionist. Por kur thoni që subvencionet I ndanë komisioni ajo nuk qëndron, Nuk pyetën fare anëtarët e komisionit, ato ndarje I bënë parapolitika. Me dhjetëra raste I di që nuk I keni dhënë subvencione vetëm sepse s’ ka qenë I partisë tuaj. Nëse doni jua them me emra.

z. Lorenc Marleku, drejtor I bujqësisë: Ju e dini shumë mirë që unë nuk I shoh bazat partiake dhe nuk I shikoj në atë aspekt njerëzit, nëse keni emra thoni.

z. Esat Raci: Invalidi I luftës, Naser Gashi ka aplikuar nuk ka përfituar. Fermeri nga Jashanica që 8 vite që punon nuk ka përfituar, Nga Shtupeli I din ti mirë cilët janë. Nuk ka shkuar fare komisioni dhe ju I keni kamufluar pastaj duke ju thënë që mos të flasin.

z. Zenun Elezaj, kryetar: E kuptoj këtë narrativë por ne jemi munduar që të ju japim subvencione të gjithëve. Nuk mund të flitet për ndasi politike. Qëllimi ynë ka qenë që ta rrisim

numrin e përfituesve. Është e pa mundur që të gjithë të marrin. Më së shumti problem kemi se NIF mund ta marrin edhe baba edhe djali. Nëse keni arsye dhe emra le të vijnë tek unë dhe unë do të I trajtoj këto raste.

Pika 6 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi I propozim vendimit nga drejtoria e urbanizimit për vënie në diskutim publik të draft planit zhvillimor komunal 2025-2033

Kryesuesi tha se bashkangjitur kërkesës së drejtorisë është edhe kërkesa nga ministria. Ai e lexoi edhe shkresën nga ministria e cila thotë se mund ta bëjë hapjen për shqyrtim për vënie në diskutim publik. Kryesuesi ftoj të gjithë anëtarët e kuvendit dhe qytetarët që të marrin pjesë në këtë diskutim publik sepse është I rëndësishëm për komunën e Klinës.

z. Kole Prenaj: Është një dokument shumë më rendësi. Kush I fiton zgjedhjet e gëzoftë dhe e impelmentoft ashtu siç duhet. Ndoshta nuk kemi nevojë më dhënë vërejtje as sugjerime por disa këshilla I kam për ti dhënë. Ka gjera që nuk janë vërejte nga kompania dhe ekipi ynë I angazhuar. Kemi pas organizuar një punëtori për hartimin e planit zhvillimor të parin dhe ka pas dalë mjaft e suksesshme dhe me vetëm 5 mijë euro shpenzime. Kemi mjaft ekspertë që mund të kontribuojnë.

z. Prenaj në përgjithësi foli për rëndësinë e planifikimit të mirë në shumë aspekte të rëndësishme që prekin interesin e komunës. Folli për rëndësinë e diversitetit, mbrojtjen e tokave bujqësore etj. Ai tha se nuk kemi çka të bazohemi në resurset njerëzore sepse po dalin çdo ditë njerëzit por duhet të orientohemi se si të krijojmë mundësi që të I mbajmë këtu.

Me ndërhyrjen e kryesuesit I cili z. Prenaj I propozoj që këtë debat ta zhvilloj në diskutim publik rreth këtij draft plani pasi që tani do të merret vetëm vendim për vënie në diskutim publik gjithmonë duke u dakorduar për propozimin e tij të parë që të organizohet një punëtori rreth plotësimit sa më të mirë të planit zhvillimor komunal.

Me 14 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA.

Kryesuesi gjithashtu vendosi që nga seanca e radhës pika 3 e rendit të ditës: Pyetje dhe përgjigje të kaloj në pikën e fundit të rendit të ditës.

Pika 7 e rendit të ditës: Shqyrtimi I raportit të konsultimeve publike Janar 2024

Znj. Vlora Tafilaj, zyra për informim: Të nderuar, si zyrtare përgjegjëse për konsultime publike po e paraqes raportin e punës për vitin 2024. Me përgjegjësi të plotë e them se Komuna e Klinës për këtë periudhë kohore ka pasur planifikimin më të madh të konsultimeve publike, të dëgjimeve publike etj. me gjithsejtë 17 procedura. Kemi pasur 4 takime publike, dy kanë qenë obligative të kryetarit të Komunës dhe në bashkëpunim me kuvendin I kemi organizuar dhe miratuar gjithsejtë 7 dokumente. Sa I përket rregullores për transparencë , dhe planit të veprimit për transparencë për shkak të angazhimit të shumtë që kam nuk kam mundur që të jua sjell për miratim por bashkë me zyrtarin për punët e kuvendit do të jua sjellim në muajin mars.

Znj. Tafilaj foli më tutje për të gjitha organizimet e takimeve duke thënë se me gjithë këto organizimeve të takimeve jemi në tre komunat që kemi bërë numrin më të madh të takimeve dhe 70% të kërkesave të inkorporuar. “ Në bashkëpunim me kryetarin e komunës do ta kemi edhe

draft planin për trashëgimi kulturore, draft plan programin për bujqësi dhe zhvillim rural, planin për efikasitet dhe energji etj. “

Pika 8 e Rendit të ditës: Informim mbi trajtimin e qenëve endacak

z. Qendrim Millaku, drejtor i SHPE: Ne si drejtori për çdo kontratë që kemi pasur kemi rritur buxhetin. Buxhetin e kemi rritur për 20 mijë euro për dy vitet e ardhshme. Kontrata që tani ka përfunduar këtë muaj, jemi marrë kryesisht në fshatin Sferkë dhe fshatra ku është paraqitur nevoja. Gjithashtu ju jemi përgjigjur kërkesave të qytetarëve dhe stacionit policor në Klinë. Unë kam të gjitha të dhënat të ndara me muaj se ku është punuar dhe me të gjitha dokumentet që tregojnë transparencën në realizimin e kontratës. Risia është që e kemi rritur buxhetin që ka me qenë 50 mijë euro për dy vitet e ardhshme dhe trajtimi i qenëve endacak ka me qenë edhe më i madh.

Para se të përfundoj mbledhja e kuvendit, kryesuesi tha se për të gjithë ata që janë pjesë e udhëtimit në kuadër të planifikimit të vizitës për në Itali, të i kontrollojnë pasaportat sepse minimum i validitetit të pasaportës është 6 muaj.

Duke ju uruar të gjithë besimtarëve mysliman muajin e shenjtë të ramazanit kryesuesi i mbylli punimet e seancës.

Procesmbajtës:

Skënder Behramaj

Kryesues:

Fadil Gashi



Kuvendi i Komunës Klinë

Komiteti për Politikë dhe Financa

01Nr 06-7215 /25

Klinë: 12.03 /25

PËR: Kuvendin e Komunës Klinë

Nga: Komiteti për Politikë dhe Financa

Kryesuesi i Komitetit: Fadil Gashi



REKOMANDIMET e Komitetit për Politikë dhe Financa, të datës: 07.03.2025

Komiteti për Politikë dhe Financa, në mbledhjen e III-të të rregullt për vitin 2025, përveç pikave të parapara me rend dite, shqyrtoi dhe miratoi për shqyrtim në Kuvend propozim-vendimin e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit për shqyrtimin dhe miratimin e raportit të monitorimit të HZK-së 2020-2028.

Pika 1. Shqyrtimi i raportit nga procesi i organizimit të konsultimit publik për rregulloren për transparencë të Komunës së Klinës dhe planin e veprimit për transparencë komunale 2025-2029 (ref. nga grupi punues).

-Sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, referoi kryesuesja e grupit punues, znj. Vlora Tafili. Theksoi se, sa i përket raportit nga procesi i organizimit të konsultimit publik për rregulloren për transparencë të Komunës së Klinës dhe planin e veprimit për transparencë komunale 2025-2029, kryetari i komunës, bazuar në udhëzimin administrativ për komunë të hapur, me kohë ka formuar komisionin i cili është marr me konsultimet publike. Gjithsej janë mbajtur dy konsultime publike, ku janë marrë të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet. Nga këto, 15 kërkesa janë pranuar, 1 është refuzuar dhe 1 është pranuar pjesërisht. Po ashtu, kërkoi që ky raport të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të raportit nga procesi i organizimit të konsultimit publik për rregulloren për transparencë të Komunës së Klinës dhe planin e veprimit për transparencë komunale 2025-2029, rekomandoi që i njëjti të kalojë për shqyrtim në Kuvend.

Pika 2. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për transparencë e Komunës së Klinës.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, znj. Vlora Tafili theksoi se, bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Udhëzimin Administrativ për Komunë të Hapur dhe Statutin e Komunës, Kuvendi i Komunës duhet të miratojë këtë draft-rregullore për transparencë. Kjo rregullore përcakton rregullat për transparencë të punës së organeve komunale, duke filluar nga Kuvendi dhe Ekzekutivi, ku parashihet edhe lloji i dokumenteve të cilat publikohen. Po ashtu, kërkoi që, nëse ka ndonjë propozim për plotësim-ndryshim të kësaj draft-rregulloreje, mund ta paraqes kërkesën për plotësim.

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të draft-rregullores për transparencën e Komunës së Klinës, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, rekomandoi që e njëjta të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Pika 3. Shqyrtimi i planit të veprimit për transparencë 2025-2029.

Nga grupi punues referoi kryesuesja e këtij grupi, znj. Vlora Tafili, ku theksoi se Plani i Veprimit për Transparencë Komunale ka për qëllim t'i ofrojë publikut qasje të lehtë në monitorimin dhe zbatimin e politikave nga organet e komunës, duke përfshirë informim të shpejtë, të dhëna të qasshme, publikim të të gjitha akteve normative dhe dokumenteve me interes publik, si dhe rritje të mundësive të pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse.

Udhëzimi Administrativ (MAPL) NR. 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, në nenin 42 përcaktohet obligimi i komunave për të hartuar planin katër (4) vjeçar të veprimit për transparencë. Ky plan kërkon të përfshijë veprime që promovojnë:

Mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve; Takimet publike; Takimet konsultative për projekt akte; Transparencën në planifikimin dhe shfrytëzimin e buxhetit të komunë; Qasje të shpejtë në shërbime; Procedurat transparente të Prokurimit; Procedurat të punësimit; Përditësimin e aktiviteteve ditore në faqe zyrtare; Përfshirjen aktive të qytetarëve në vendimmarrje. Po ashtu, kërkoi që ky plan të shqyrtohet dhe miratohet në Kuvend.

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të planit të veprimit për transparencë 2025-2029, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, rekomandoi që i njëjti të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Pika 4. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit për shqyrtimin dhe miratimin e raportit të monitorimit të HZK-së 2020-2028.

-Sa i përket kësaj pike, e cila hyri si pikë shtesë në rend të ditës, referoi drejtori nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, z. Enver Berisha. Ai theksoi se Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, bazuar në procedurat ligjore në fuqi, ka bërë një raport të monitorimit të HZK-së 2020-2028, i cili i paraprin revidimit të Hartës Zonale. Në këtë raport përfshihet analiza se sa ka ngecje dhe sa është e zbatueshme Harta Zonale. Bazuar në këto, ne mund të fillojmë me pas revidimin e Hartës Zonale. Po ashtu, kërkoi që ky raport të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të raportit për monitorimin e Hartës Zonale 2020-2028, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, rekomandoi që i njëjti të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.



Kuvendi i Komunës Klinë

01Nr prot. 6125 /2025

Datë: 28.02 /2025

Duke u mbështetur në nenin 12 paragrafi 12.2 shkronjën d), nenin 17 shkronja b), s) dhe nenit 40. paragrafi 40.2 shkronjën l) të Ligjit për Vetqeverisje Lokale 03/L-040. Nenit 10 nen pikën 4) dhe nenin 15 të Statutit të Komunës së Klinës, nenin 10 dhe 15 të Ligjit Nr 04/L-174 për planifikim hapësinor, neni 7 paragrafi 2 Udhëzimit Administrativ MMPH-Nr.05/2014 për përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesmarrjen e publikut në planifikim hapësinor. Nenit 22 të Udhëzimit Administrativ (MAPL)Nr.04/2023 për administratën të hapur në komunë si dhe me pelqimin e dhënë nga MMPHI me nr. SP-O2-8601-2 i datës 14.02.2025, me kërkesën e DUMM-së, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e II-të të rregullt për vitin 2025 të mbajtur me 28.02.2025, mori këtë:

V E N D I M

Për

vënie në diskutim publik draft-planin zhvillimor komunal të Klinës 2025-2033

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, për venienë në diskutim publik Draft-Planin Zhvillimor Komunal 2025-2033.
2. Vënia në diskutim publik behët me qëllimin e dhenjës së kontributit nga të gjitha institucionet dhe qytetarët e Komunës së Klinës.
3. Konsultimet publike do të organizohen ashtu siç parashihet me U.A. MMPH-Nr.05/2014 për përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesmarrjen e publikut në planifikim hapësinor dhe U.A. (MAPL)Nr.04/2023 për administratën të hapur në komunë.
4. Vendimi hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore të cilat janë në fuqi dhe pas publikimit në web faqen zyrtare të komunës.

Njoftohen:

- MAPL;
- Kryetari i Komunes;
- Drejtorja për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit;
- Zyra për Informim;
- Arkivi.

Kryesues i Kuvendit
Fadil Gashi